



Në bazë të nenit 163 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 82/18 dhe “Gazeta zyrtare e RMV-së nr.178/21), neni 207 dhe 321 i Statutit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup dhe nenit 21 dhe 49 nga Rregullorja për kushtet e posaçme dhe procedurës për përzgjedhje në thirjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe thirjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup numër 02-174/2 e datës 06.04.2021, e lidhur me Vendimin e Drejtorisë Rektoriale të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup e datës 20.09.2023, Drejtoria Rektoriale e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup shpall:

### KONKURS INTERN PLOTËSUES

Për angazhimin e demonstratorëve në Fakultetet e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, për vitin akademik 2023/2024 edhe atë:

- Nga fusha e kontabilitetit ..... (1) demonstratorë
- Nga fusha e shkencave të matematikës ..... (1) demonstratorë
- Nga fusha e informatikës ..... (2) demonstratorë
- Nga fusha e shkencave të sportit ..... (1) demonstratorë
- Nga fusha e mediave ..... (1) demonstratorë
- Nga fusha shkencave politike dhe administrative ..... (1) demonstratorë

Për demonstratorë mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet e përgjithshme sipas Ligjit për Arsim të Lartë dhe është student në ciklin e dytë ose të tretë të studimeve në programin adekuat studimor.

Kriteriumet për notimin e kandidatëve janë siç vijon:

- a. mesatarja e përfundimit të studimeve deridiplomike (40% nga numri i përgjithshëm i poenave)
- b. mesatarja nga lëndët e domosdoshme të programit studimor në të cilin kandidati ka kryer studimet deridiplomike (50% nga numri i përgjithshëm i poenave)
- c. 10% nga intervista (notë nga kualiteti arsimor profesional të cilin do ta mbulojë)

Përparësi kanë kandidatët të cilët kanë kryer studimet në universitetet të ranguar më lartë. (përlllogaritet faktori i rëndësisë përkatësisht koeficienti sipas rangimit të Universitetit)

Që të zgjidhet kandidati duhet ti plotësojë kriteriumet minimale të parapara në Ligjin për Arsim të Lartë, Rregulloren për kushtet e posaçme dhe procedurës për përzgjedhje në thirjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe në thirje bashkëpunëtori në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup si dhe Statutin e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup.

Demonstratori do të angazhohet minimum dy (2), por jo më shumë se në tre (3) lëndë, përkatësisht së paku gjashtë (6), deri maksimum dhjetë (10) orë në javë.

Për angazhim të plotë maksimal demonstratorit i takon kompenzim në shumë neto deri 10.000 denarë në muaj, varësisht nga orët e mbajtura.

Demonstratorët do të zgjidhen pas shpalljes së konkursit intern, për vitin akademik 2023/2024.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Fletëparaqitje



- Biografi të shkurtë CV (me kontakt telefon dhe e-mail adresë)
- Dëshmi se është student i ciklit të dytë ose tretë të studimeve në programin adekuat ose se është i regjistruar.
- Dëshmi se e ka të kryer ciklin e parë të studimeve sipas EKTS me 180 ose 240 EKTS kredi me mesatare në minimum 8,00.
- Vërtetim për provimet e dhëna në ciklin e parë të studimeve;
- Vërtetim për provimet e dhëna në ciklin e dytë të studimeve;
- Vërtetim për provimet e dhëna në ciklin e tretë të studimeve – nëse posedon;
- Vërtetim për njohjen e gjuhës Maqedone dhe Shqipe nëse studimet i ka të kryera në gjuhë tjetër.

Fletë aplikimet me dokumentet e kërkuara, të jenë origjinal ose të verifikuara në noter, duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur në kampusin e Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, në rrugën Samoillova (në ish Kazermën Ilinden), kati i 3-të zyra nr. 308 e sekretarit teknik të Rektorit, me shënimin "konkurs për angazhim si demonstrator nga fusha \_\_\_\_\_."

Me dorëzimin e fletëparaqitjes kandidatët për demonstrator janë dakord për tu regjistruar në bazën e kandidatëve për demonstrator në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup.

Fletë aplikimet jo të plota dhe ata që nuk i dorëzojnë në kohën e duhur nuk do të merren parasysh.

Afati i fundit për aplikim: 09.10.2023.

Kontakt telefoni: 02/3161-004

Me respekt,

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup